

VENDIM
Nr. 154, datë 31.7.2024

**MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “AGE ERZEN” SHPK NË VEPRIMTARINË E
PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC “HEKALI”**

(Ndryshuar me vendimin nr. 314, datë 12.12.2025)

(i përditësuar)

Në mbështetje të neneve 16, 37, pika 2, germa “a”, 38, pika 1, germa “a” dhe 39, pika 4, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 4, pika 1, germa “a”, nenit 5, pika 1, germa “a”, neneve 13 dhe 14, pika 9 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 31.7.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 814/16 prot., datë 29.7.2024, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Age Erzen’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC ‘Hekali’”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Age Erzen” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 814/3 prot., datë 31.5.2024, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Hekali”, me kapacitet të instaluar 1940 kw, me vendndodhje në pellgun ujëmbledhës të lumit Erzen, Bashkia Tiranë.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 127, datë 25.6.2024, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Age Erzen” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Hekali”, me kapacitet të instaluar 1940 kw, me vendndodhje në pellgun ujëmbledhës të lumit Erzen, Bashkia Tiranë.

- ERE botoi njoftimin në medien e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 26.6.2024 dhe 27.6.2024) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 5.7.2024), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.

- Me shkresën nr. 1641 prot., datë 15.7.2024, ERE ka njoftuar dhe MIE-n mbi fillimin e procedurës së licencimit të kësaj shoqërie.

- Me shkresën me nr. 814/9 prot., datë 28.6.2024, ERE i është drejtuar shoqërisë, duke i njoftuar vendimin e fillimit të procedurës dhe duke i kërkuar plotësimin e dokumentacionit të konstatuar të paplotësuar apo të plotësuar pjesërisht. Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 814/10 prot., datë 8.7.2024, shoqëria ka depozituar dokumentacion plotësues të aplikimit.

- Pas shqyrtimit të këtij dokumentacioni, ka rezultuar se mbetet ende dokumentacion për t’u plotësuar, ndaj ERE i është drejtuar shoqërisë me shkresën nr. 814/11 prot., datë 19.7.2024. Në përgjigje, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 814/12 prot., datë 23.7.2024, shoqëria ka depozituar dokumentacionin plotësues të aplikimit.

- Për sa më sipër, me qëllim shqyrtimin dhe analizimin e dokumentacionit të depozituar nga shoqëria dhe zhvillimin e ndonjë korrespondence të mundshme me të, me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 149, datë 25.7.2023, u vendos zgjatja deri në 20 (njëzet) ditë e afatit të vendimmarrjes

së Bordit të ERE-s për aplikimin e shoqërisë “Age Erzen” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

- ERE njoftoi shoqërinë për këtë vendimmarrje me *e-mail*-in e datës 26.7.2024, protokolluar në ERE me nr. 814/14 prot., datë 26.7.2024, ku, gjithashtu, iu evidentua dhe dokumentacioni, i cili ende mbetet i paplotësuar nga ky aplikim. Me *e-mail*-in e protokolluar në ERE me nr. 814/15 prot., datë 29.7.2024, shoqëria ka depozituar informacion plotësues të aplikimit.

- Nga analizimi i aplikimit, në referencë të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, rezulton se shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të aneksit A dhe ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar në pikën 1.1, germat “a” “b” dhe “c”; pikën 1.2, germat “a”, “b”, “c” dhe “d”; pikën 1.3 germat “a”, “b” dhe “c”; për pikën 2.1 germat “a”, “b”, “c”, “d”, “e” dhe “f”.

- Rezulton se shoqëria “Age Erzen” sh.p.k.:

- Ka nënshkruar me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) kontratën nr. 1655 rep., nr. 367/3 kol., datë 3.12.2020, “Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin hidrocentralit ‘Hekal’, me kapacitet 1940 kw, në pellgun ujëmbledhës të lumit Erzen, Bashkia Tiranë”;

- Është pajisur me lejen për përdorimin e burimit ujqor, lëshuar nga Këshilli i Basenit Ujqor Erzen, datë 18.9.2020, miratuar me vendimin e Këshillit të Basenit Ujqor nr. 5, datë 16.9.2020, për prodhim hidroenergjqie nga HEC “Hekali”;

- Ka nënshkruar me shoqërinë “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes” sh.a. marrëveshjen nr. 1966/2 prot., datë 17.4.2020, për lidhjen e HEC “Hekal”, me fuqi 1940 kw, me rrjetin e shpërndarjes;

- Është pajisur me vendim për VNM paraprake, lëshuar më 9.6.2022 nga Agjqencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), për të zhvilluar projektin “Ndërtimi dhe operimi i HEC “Hekal”, me fuqi të instaluar 1940 kw” dhe ka dokumentuar në ERE fillimin e punimeve brenda afatit të vlefshmërisë së kësaj VNM-je.

- Shoqëria disponon aktualisht një leje të vlefshme për përdorimin e burimit ujqor për prodhim hidroenergjqie nga HEC “Hekal”, e cila është aktualisht e vlefshme, por duke qenë se afati i saj nuk mbulon të gjithë periudhën e licencimit, do t’i lihet kusht shoqërisë që të depozitojë në ERE lejen e rinovuar brenda afatit të fundit të vlefshmërisë së saj, pra brenda datës 18.9.2025.

- Vlerësohet që t’i lihet kusht shoqërisë që, në rast se nuk depoziton lejen e rinovuar të përdorimit të burimit ujqor, brenda këtij afati dhe ka një urdhër për ndërprerjen/pezullimin e veprimtarisë nga inspektoratet/agjqencitë e mbrojtjes së territorit/mjedisit, atëherë ajo nuk ka të drejtë të operojë/ushtrojë veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

- Shoqëria ka dokumentuar në ERE letrën e interesit përkatëse për të realizuar projektin 100% me kredi bankare, sipas vlerës që rezulton nga kontrata me MIE-n, si dhe referuar mënyrës së financimit të parashikuar në planin e saj të biznesit. Shoqëria, po ashtu ka informuar ERE-n se disbursimi i kredisë do të fillojë menjëherë pas licencimit në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike. Për sa i përket financimit të deritanishëm, shoqëria ka deklaruar se është dakordësuar me kontraktorin e përgjithshëm që likuidimet përkatëse do të kryhen pas disbursimit të kredisë dhe me certifikimin e punimeve. Në këto rrethana vlerësohet që t’i lihet kusht shoqërisë që të depozitojë në ERE, dakordësinë e kontraktorit të punimeve, të shprehur me një aktmarrëveshje, deklaratë apo çdo akt tjetër ndërmjet palëve për financimin e shpenzimeve për ndërtimin e veprës deri në disbursimin e kredisë dhe certifikimin e punimeve, si dhe për mënyrën e shlyerjes së këtij investimi.

- ERE, në zbatim të nenit 38, pika 1, germa “a” të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, dhe nenit 5, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, lëshon një licencë për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike deri në 30 vjet, afat i cili do të fillojë nga data e parashikuar nga shoqëria për fillimin e operimit, pra nga data 1.3.2026.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Age Erzen” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Hekali”, me kapacitet të instaluar 1940 kw, me vendndodhje në pellgun ujëmbledhës të lumit Erzen, Bashkia Tiranë, për një afat 30-vjeçar, duke filluar nga data 1.6.2026.

2. *Shoqëria ‘Age Erzen’ sh.p.k. duhet të depozitojë në ERE lejen e rinovuar të përdorimit të burimit ujor brenda datës 8.1.2030.*

3. Në rast se shoqëria nuk depoziton lejen e rinovuar të përdorimit të burimit ujor brenda afatit të përcaktuar në pikën 2 të këtij vendimi dhe ka një vendim për ndërprerjen/pezullimin e veprimtarisë nga inspektoratet/agjencitë e mbrojtjes së territorit/mjedisit, atëherë ajo nuk ka të drejtë të operojë/ushtojë veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

4. *Shfuqizuar.*

5. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë shoqërinë “Age Erzen” sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencinë e Menaxhimit të Burimeve Ujore, “Furnizuesin e Tregut të Lirë” sh.a. dhe “Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes” sh.a. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti